Numër: 01-93
Datë: 21.02.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.02.2025 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. **RIAKREDITOHET** "Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF)", me adresë: Rr. Nazmi Gafurri,Nr.15, Prishtinë, Republika e Kosovës, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1. **TEKNIK I KONTABILITETIT,** Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 55 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2029. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga pesëdhjetë (50) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në gjashte (6) grupe.

   1.2. **KONTABILIST I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 96 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2029. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga pesëdhjetë (50) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në gjashtë (6) grupe.

   1.3. **AUDITOR I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 100 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2029. Institucioni mund të realizojë

procesin e trajnimit me nga tridhjetepesë (35) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe.

1.4. **AUDITOR I BRENDSHËM NË SEKTORIN PRIVAT DHE PUBLIK**, niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 60 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2029 Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga tridhjetë (35) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe.

1.5. **VLERËSUES I BIZNESEVE I CERTIFIKUAR**, niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 50 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2029. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe.

1.6. **VLERËSUES I BIZNESEVE I LICENCUAR**, niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 50 kredi të AAP, për periudhën katër (4) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2028. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

1.7. **EKSPERT I LICENCUAR I FORENZIKËS FINANCIARE,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 60 kredi të AAP, për periudhën katër (4) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2028 Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

1.8. **KËSHILLTAR TATIMOR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 49 kredi të AAP, për periudhën katër (4) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2028. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga pesëdhjetë (50) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe.

1.9. **KËSHILLTAR TATIMOR I LICENCUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 60 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2029 Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

1.10. **KONTROLLOR I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 36 kredi të AAP, për periudhën katër (4) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2028 Institucioni mund të realizojë

procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (20) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

1.11. **KONTROLLOR I LICENCUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 24 kredi të AAP, për periudhën katër (4) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2028. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidatë brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

1.12. **AUDITOR I IT I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 40 kredi të AAP, për periudhën katër (4) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2028 Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzet (20) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

1.13. **MENAXHER I RISKUT I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 40 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2029. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

1.14. **CFO I CERTIFIKUAR,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 50 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2029 Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

1.15. **ZYRTAR I CERTIFIKUAR NE MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 55 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2029 Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

1.16. **Certifikimi IPSAS,** niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E) me 55 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2024 deri 19.08.2029 Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

2. Institucioni obligohet të plotësojnë kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Obligohet AKK të bëjë monitorimin e përmbushjes së këtyre kushteve.

4. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetim

Institucioni IKAF, me datë 22.08.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimet e cekura në pikën nr. 1 të këtij vendimi.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim për kualifikimet si më lartë.

Ekipet e ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit, me datë 29.05.2024 kanë realizuar vizitën në institucionin IKAF, sipas afateve ligjore kanë përpiluar raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim për kualifikimet për të cilat institucioni ka parashtruar kërkesë bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës.

Raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 23.01.2025.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për rivalidim të kualifikimeve, aplikacionet për riakreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitës së realizuar tek pala aplikuese.

Këshilli Drejtues i AKK-së me qëllim të zbatimit të drejtë të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë ka nxjerr vendimin Nr.01/402 të datës 13.06.2024, sipas të cilit janë të përcaktuara kriteret që Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional duhet ti përmbushin në afat kohor 3 deri 6 muaj. Ndërsa AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/ 03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së Institucionit "IKAF , për riakreditim dhe rivalidim, rekomandimeve përfundimtare të ekipeve të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese

për akreditim dhe validim për institucionin aplikues, të gjeturave në raportet vlerësuese, si dhe nga të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF), dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Dr.Besim Mustafa

Kryetar KD së AKK